Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

**O - Oferta**

**MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme**

**N - Numri i ofertave të vlefshme**

**PR (Zm) – Zbritje e mundshme**

**MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N**

**PR = 85 % Mo**

**Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR ..... rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët**

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

## **D. DHËNIA E KONTRATËS**

### **23. Njoftimi i Fituesit**

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

### **24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare;
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

## **DH. ANKESAT**

### **25. Procedura e ankesës**

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e

---

prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

## **E. ANULIMI I PROCEDURËS**

### **26. Anulimi i procedurës**

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
  - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
  - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
  - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
  - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
  - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.  
me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

- Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike
- Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës
- Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial.....
- Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit
- Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike .....
- Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit .....
- Shtojca 8: Termat e Referencës
- Shtojca 9: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve .....
- Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....
- Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit .....
- Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit
- Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit
- Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit
- Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit
- Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

## Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE<sup>5</sup>

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sgarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
  1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  2. Njoftimin e Kontrates;
  3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
  5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

<sup>5</sup> Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

**Shtojca 2.**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

**LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**  
\_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë**  
(në rast BOE): \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi për njësi</b>	<b>Çmimi total (3 x 4X)</b>	
1.					
2.					
3.					
4.					
	<b>Çmimi total</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					
<b>Nënshkrimi</b>					
<b>Vula</b>					
<b>Datë</b> _____					

---

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)  
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

#### **Shtojca 4.**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

#### **Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### **VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

---

**Shtojca 5.**

*(<sup>6</sup>Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)*

**DEKLARATË**  
**Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit**

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt \_\_\_\_\_ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt \_\_\_\_\_, është i pamiruar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

**Vula**

---

<sup>6</sup> Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

---

## Shtojca 6 .

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Objekti i shërbimit konsiston në zbatimin e një ndërhyrjeje të integruar për menaxhimin e qëndrueshëm të kafshëve endacake (qen dhe mace) në territorin administrativ të Bashkisë Himarë, përmes modelit “Kap–Sterilizo–Vaksino–Lësho”, me qëllim reduktimin gradual të popullatës, përmirësimin e shëndetit publik, rritjen e sigurisë së komunitetit dhe mbrojtjen e imazhit turistik të zonës. Shërbimi duhet të realizohet në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi për shërbimin veterinar, mirëqenien e kafshëve dhe mbrojtjen e shëndetit publik, si dhe me standardet bashkëkohore veterinare dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare. Operatori ekonomik duhet të sigurojë kapacitet të plotë organizativ dhe teknik për realizimin e të gjitha fazave të ndërhyrjes, duke përfshirë identifikimin dhe monitorimin e territorit, kapjen humane të kafshëve, transportin në kushte të kontrolluara, trajtimin veterinar, sterilizimin ose kastrimin, vaksinimin, trajtimin antiparazitar, identifikimin individual dhe rikthimin në habitatin origjinal pas përfundimit të trajtimit.

Të gjitha veprimet duhet të kryhen nga personel veterinar i licencuar dhe i kualifikuar, me përvojë në ndërhyrje kirurgjikale dhe menaxhim të kafshëve endacake, duke garantuar standarde të larta të mirëqenies së kafshëve dhe minimizim të stresit dhe dhimbjes gjatë procedurave.

Kapja e kafshëve duhet të realizohet në mënyrë humane, pa përdorim të metodave të dhunshme, duke përdorur pajisje dhe teknika të aprovuara veterinare që minimizojnë rrezikun për kafshën dhe operatorët. Procesi duhet të organizohet në mënyrë të tillë që të mos krijojë shqetësim për komunitetin, duke u kryer kryesisht në orare me qarkullim të reduktuar dhe me planifikim paraprak sipas zonave prioritare, veçanërisht në zonat urbane dhe turistike me densitet të lartë. Transporti i kafshëve të kapura duhet të kryhet me mjete të dedikuara, të licencuara për transport kafshësh, të pajisura me kafaze individuale që garantojnë ajrosje të mjaftueshme, siguri fizike dhe stabilitet gjatë lëvizjes. Mjetet e transportit duhet të jenë të dezinfektuara rregullisht për të shmangur transmetimin e sëmundjeve infektive dhe duhet të sigurojnë kohë sa më të shkurtër transporti drejt qendrës veterinare.

Sterilizimi dhe kastrimi duhet të realizohen në ambiente klinike veterinare të licencuara, të pajisura me kushte sterile dhe pajisje kirurgjikale bashkëkohore. Procedurat duhet të kryhen nën anestezi të kontrolluar dhe në përputhje me protokollet standarde veterinare, duke siguruar monitorim të plotë para, gjatë dhe pas ndërhyrjes. Për çdo kafshë duhet të kryhet vlerësim paraprak shëndetësor për të përcaktuar përshtatshmërinë për ndërhyrje kirurgjikale.

Pas ndërhyrjes kirurgjikale, operatori duhet të sigurojë trajtim post-operator në ambiente të përshtatshme, ku kafshët mbahen nën monitorim deri në rikuperim të plotë. Gjatë kësaj faze duhet të administrohen medikamente sipas protokolleve veterinare, përfshirë antibiotikë dhe antiinflamatorë, si dhe të sigurohet kujdes për plagët kirurgjikale, ushqyerje e kontrolluar dhe kushte higjienike të përshtatshme.

Të gjitha kafshët e trajtuara duhet të i nënshtrohen vaksinimit, me fokus të veçantë vaksinën kundër tërbimit, si dhe trajtimin antiparazitar të brendshëm dhe të jashtëm. Çdo procedurë vaksinimi dhe trajtimi duhet të dokumentohet në mënyrë të detajuar, duke përfshirë të dhënat e produktit të përdorur, serinë, datën e administrimit dhe identifikimin individual të kafshës.

---

Operatori ekonomik duhet të sigurojë sistem të plotë matrikullimi dhe regjistrimi për çdo kafshë të trajtuar, duke krijuar kartelë individuale shëndetësore që përmban të gjitha të dhënat që nga momenti i kapjes deri në rikthimin në territor. Identifikimi mund të realizohet përmes matrikullit fizik ose metodave të tjera të miratuara nga autoritetet përkatëse, duke garantuar gjurmueshmëri të plotë të çdo individi.

Gjatë gjithë zbatimit të kontratës, operatori duhet të realizojë monitorim të vazhdueshëm të situatës në terren, duke identifikuar zonat me përqendrim të lartë të kafshëve endacake dhe duke përshtatur ndërhyrjet sipas dinamikës sezonale, veçanërisht në periudhat me fluks të lartë turistik. Monitorimi duhet të shoqërohet me raportim periodik të strukturuar, ku pasqyrohen të dhënat mbi numrin e kafshëve të kapura, të trajtuara, të vaksinuara dhe të rikthyera, si dhe çdo problematikë e hasur gjatë zbatimit.

Operatori duhet të garantojë bashkëpunim të ngushtë me autoritetin kontraktues dhe me shërbimin veterinar shtetëror, duke siguruar transparencë të plotë në çdo fazë të procesit dhe duke vënë në dispozicion dokumentacionin përkatës për verifikim dhe kontroll. Gjithashtu, duhet të sigurohet kapacitet operacional i mjaftueshëm për përballimin e intensitetit të punës gjatë sezonit turistik, kur nevoja për ndërhyrje është më e lartë.

Shërbimi synon krijimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe afatgjatë të menaxhimit të kafshëve endacake, duke reduktuar në mënyrë progresive popullatën e tyre, duke përmirësuar treguesit e shëndetit publik dhe duke kontribuar në rritjen e sigurisë dhe cilësisë së jetës në territorin e Bashkisë Himarë.

---

**Shtojca 7.**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

**FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT****Shërbimet që kërkohen që kërkohen:**

55 (pesëdhjetë e pesë) ndërhyrje të plota veterinarë.

Çdo ndërhyrje përfshin kapjen dhe trajtimin e qenve dhe maceve endacake, sterilizimin/kastrimin, vaksinimin kundër tërbimit, trajtimin antiparazitar, regjistrimin dhe matrikullimin 100% të kafshëve të trajtuara dhe trajtimin post-operator dhe monitorim veterinar.

**Afatet e ekzekutimit:** 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike nga lidhja e kontratës

---

## **Shtojca 8.**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

### **TERMAT E REFERENCES**

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve.

Objekti i këtij shërbimi është realizimi i një ndërhyrjeje të plotë, të integruar dhe të qëndrueshme për kufizimin, kontrollin dhe menaxhimin e popullatës së kafshëve endacake në territorin administrativ të Bashkisë Himarë, duke përfshirë në mënyrë të veçantë qentë dhe macet e paregjistruara dhe pa pronar, të cilat paraqesin rrezik potencial për shëndetin publik, sigurinë e qytetarëve dhe funksionimin normal të hapësirave urbane dhe turistike. Ky shërbim synon të vendosë një sistem të organizuar dhe profesional të menaxhimit të këtyre kafshëve, i cili nuk bazohet në largim apo eliminim, por në një qasje humane, etike dhe të bazuar në standarde bashkëkohore veterinarë, të njohur ndërkombëtarisht si modeli Kap–Sterilizo–Vaksino–Lësho.

Qëllimi kryesor i shërbimit është reduktimi i qëndrueshëm dhe afatgjatë i numrit të kafshëve endacake përmes ndërprerjes së ciklit të riprodhimit, përmirësimit të gjendjes shëndetësore të kafshëve ekzistuese dhe minimizimit të rrezikut të përhapjes së sëmundjeve zoonotike, duke kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në mbrojtjen e shëndetit publik dhe në rritjen e cilësisë së jetës së komunitetit lokal. Në të njëjtën kohë, ky shërbim synon të përmirësojë ndjeshëm imazhin e Bashkisë Himarë si një destinacion turistik i sigurt, i pastër dhe i menaxhuar sipas standardeve moderne të mirëqenies publike dhe mjedisore.

Shërbimi është gjithashtu i orientuar drejt krijimit të një sistemi të qëndrueshëm monitorimi dhe ndërhyrjeje, i cili lejon menaxhimin afatgjatë të fenomenit të kafshëve endacake, duke siguruar vazhdimësi të kontrollit edhe pas përfundimit të ndërhyrjeve intensive fillestare. Në këtë kuadër, qëllimi nuk kufizohet vetëm në uljen numerike të kafshëve endacake, por shtrihet në ndërtimin e një mekanizmi funksional institucional dhe operacional që garanton kontroll të vazhdueshëm, ndërgjegjësim të komunitetit dhe përmirësim të praktikave të menaxhimit të kafshëve në territor.

Përshkrimi i detyrave dhe shërbimeve.

Operatori ekonomik i kontraktuar është përgjegjës për realizimin e plotë të të gjitha aktiviteteve që lidhen me menaxhimin e kafshëve endacake, duke filluar nga faza e identifikimit dhe monitorimit të situatës në terren dhe deri në rikthimin e kafshëve të trajtuara në habitatin e tyre natyral. Ky proces duhet të zhvillohet në mënyrë të koordinuar, të dokumentuar dhe të kontrolluar, duke respektuar në çdo hap standardet veterinarë në fuqi dhe parimet e mirëqenies së kafshëve.

Në fazën e parë të ndërhyrjes, operatori duhet të realizojë monitorimin sistematik të territorit të Bashkisë Himarë me qëllim evidentimin e zonave me përqendrim të lartë të kafshëve endacake, identifikimin e pikave kritike urbane dhe turistike, si dhe krijimin e një harte funksionale të shpërndarjes së popullatës së tyre. Ky proces duhet të bazohet në vëzhgime të drejtpërdrejta në terren, raportime nga komuniteti dhe bashkëpunim me strukturat vendore, duke krijuar një bazë të dhënash të strukturuar që shërben për planifikimin e ndërhyrjeve të mëtejshme.

---

Në vijim, operatori duhet të realizojë kapjen humane të kafshëve endacake, duke përdorur metoda dhe pajisje të aprovuara që sigurojnë minimizimin e stresit, dhimbjes dhe rrezikut për kafshën dhe stafin operativ. Kapja duhet të kryhet nga personel i trajnuar dhe me përvojë, në mënyrë të kontrolluar dhe të planifikuar sipas prioriteteve territoriale dhe dinamikës sezonale të zonës, me fokus të veçantë në zonat urbane dhe ato me fluks të lartë turistik.

Pas kapjes, operatori është përgjegjës për transportin e kafshëve në qendra të licencuara veterinare, duke siguruar kushte të përshtatshme transporti që garantojnë siguri fizike, ajrosje të mjaftueshme dhe reduktim të stresit gjatë lëvizjes. Transporti duhet të realizohet me mjete të dedikuara dhe të dezinfektuara rregullisht, në përputhje me standardet përkatëse të bio-sigurisë.

Në ambientet klinike veterinare, operatori duhet të realizojë ekzaminimin shëndetësor paraprak të çdo kafshe, me qëllim vlerësimin e gjendjes së saj fizike dhe përcaktimin e përshtatshmërisë për ndërhyrje kirurgjikale. Më pas, duhet të kryhen procedurat e sterilizimit ose kastrimit në kushte sterile dhe me anestezi të kontrolluar, të realizuara nga mjekë veterinerë të licencuar dhe të kualifikuar, duke respektuar protokollin standarde kirurgjikale dhe të sigurisë.

Pas ndërhyrjes kirurgjikale, operatori duhet të sigurojë trajtim post-operator të kontrolluar, duke përfshirë monitorimin e gjendjes shëndetësore të kafshëve, administrimin e medikamenteve të nevojshme si antibiotikë dhe antiinflamatorë, si dhe kujdesin për rikuperimin e plotë deri në momentin e rikthimit në territor. Kjo fazë duhet të garantojë që kafshët të mos rikthehen në mjedis pa qenë në gjendje të plotë shëndetësore.

Në vijim, operatori duhet të realizojë vaksinimin e kafshëve, me fokus të veçantë vaksinën kundër tërbimit, si dhe trajtimin antiparazitar të brendshëm dhe të jashtëm, duke garantuar mbrojtjen e tyre nga sëmundjet infektive dhe reduktimin e rrezikut për transmetimin e sëmundjeve zoonotike. Të gjitha procedurat duhet të dokumentohen në mënyrë të detajuar dhe të verifikueshme.

Gjithashtu, operatori duhet të realizojë matrikullimin dhe regjistrimin individual të çdo kafshe të trajtuar, duke krijuar një sistem identifikimi unik dhe një kartelë shëndetësore për secilin individ, ku regjistrohen të gjitha ndërhyrjet e kryera, trajtimet mjekësore dhe statusi i rikthimit në territor. Ky sistem duhet të sigurojë gjurmueshmëri të plotë dhe shmangie të përsëritjes së panevojshme të procedurave.

Në përfundim të ciklit të trajtimit, operatori duhet të realizojë rikthimin e kontrolluar të kafshëve në habitatin e tyre origjinal, duke siguruar që procesi të jetë në përputhje me standardet e mirëqenies së kafshëve dhe me parimet e menaxhimit human të popullatës së kafshëve endacake.

Gjatë gjithë periudhës së kontratës, operatori është i detyruar të realizojë raportim periodik të detajuar mbi aktivitetet e kryera, duke përfshirë të dhëna statistikore mbi numrin e kafshëve të kapura, të trajtuara, të sterilizuara, të vaksinuara dhe të rikthyera, si dhe informacion mbi problematikat e hasura dhe masat e marra për adresimin e tyre.

Shpërndarja, vendi dhe dorëzimi i shërbimeve

Shërbimet do të realizohen në të gjithë territorin administrativ të Bashkisë Himarë, duke përfshirë zonat urbane, rurale dhe turistike, me prioritet të veçantë zonat me densitet të lartë të popullsisë dhe fluks të shtuar sezonal të vizitorëve.

---

Ndërhyrjet do të përqendrohen kryesisht në hapësirat publike, rrugët kryesore, zonat bregdetare, zonat e grumbullimit të mbetjeve dhe çdo pikë tjetër të identifikuar si vatër e përqendrimit të kafshëve endacake gjatë procesit të monitorimit.

Operatori duhet të organizojë punën në mënyrë fleksibile dhe të përshtatshme me dinamikën sezonale të territorit, duke rritur intensitetin e ndërhyrjeve gjatë periudhës turistike dhe duke realizuar ndërhyrje më të fokusuara gjatë periudhave me aktivitet më të ulët. Planifikimi i shpërndarjes së shërbimeve duhet të bazohet në analiza të vazhdueshme të situatës në terren dhe në të dhënat e mbledhura gjatë monitorimit.

Dorëzimi i shërbimeve konsiderohet i realizuar në momentin kur kafshët e kapura janë trajtuar plotësisht sipas ciklit të plotë Kap–Sterilizo–Vaksino–Lësho, janë pajisur me identifikim individual dhe janë rikthyer në habitatin e tyre origjinal në gjendje të stabilizuar shëndetësore. Çdo fazë e shërbimit duhet të dokumentohet në mënyrë të plotë dhe t’i dorëzohet autoritetit kontraktues në formë raportesh periodike mujore dhe raporti përfundimtar në përfundim të kontratës.

Në përfundim të periudhës së kontratës, operatori duhet të dorëzojë një raport final gjithëpërfshirës, i cili përmban analizën e ndërhyrjeve të kryera, rezultatet e arritura, të dhëna statistikore të detajuara, vlerësimin e ndikimit të projektit dhe rekomandime për vazhdimësinë e menaxhimit të popullatës së kafshëve endacake në territorin e Bashkisë Himarë.

---

## Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

---

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

***Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.***

*Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.*

*Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :*

- *Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.*
- *Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.*

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

*2.1.1. Operatori ekonomik duhet të ketë të përfshirë objektin e prokurimit në objektin e veprimtarisë së deklaruar në QKB.*

*2.1.2 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij ose të disponojë nëpërmjet kontratës së punës/bashkëpunimit të paktën një (1) mjek veteriner të pajisur me Leje Profesionale të vlefshme, të lëshuar nga organet kompetente në zbatim të ligjit nr. 113/2015, datë 22.10.2015, "Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veteriner". Dokumentacioni duhet të vërtetojë vlefshmërinë e lejes në momentin e dorëzimit të ofertës.*

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

*2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 35 % e vlerës së fondit limit që prokurohet.*

#### **2.3 Kapaciteti teknik:**

*2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 15 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.*

*Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:*

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose fatura tatimore të shitjes, të*

---

plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 1 (një) mjet transporti të përshtatshëm për kapjen, transportin dhe trajtimin e kafshëve endacake.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e mjetit në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje, pas mbylljes së fazës së vlerësimit, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, dokumentacionin provues si më poshtë:

- a) leje qarkullimi në pronësi të operatorit ekonomik;
- b) kontratë qiraje;
- c) kontratë huapërdorjeje;
- d) çdo dokument tjetër që provon disponimin e ligjshëm të mjetit për periudhën e zbatimit të kontratës.

Për mjetin duhet të paraqitet leja e qarkullimit e vlefshme dhe dokumentacioni që provon kontrollin teknik dhe siguracionin e vlefshëm, sipas legjislacionit në fuqi.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 1 (një) pajisje profesionale për neutralizimin/immobilizimin në distancë të kafshëve endacake (pushkë neutralizuese me shigjeta/dart veterinare), e përshtatshme për kapjen dhe trajtimin human të kafshëve.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e pushkës në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje, pas mbylljes së fazës së vlerësimit, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, dokumentacionin provues si më poshtë:

- faturë tatimore blerjeje;
- kontratë qiraje ose huapërdorjeje;
- akt pronësie ose dokument tjetër ekuivalent që provon disponimin e ligjshëm të saj.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë klinikë/studio veterinare të licencuar, të vendosur brenda territorit të Qarkut Vlorë, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhena të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Shtojca 10.****FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

<b>Identifikimi</b>	<b>Përgjigja</b>
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	----- -----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

<b>Emri i nënkontraktorit të propozuar</b>	<b>NIPT -i</b>	<b>Përqindja e nënkontraktimit</b>	<b>Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar</b>

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

<b>Emri (at) e subjekteve</b>	<b>NIPT-i</b>	<b>Lloji i kapacitetit për të cilin do të</b>	<b>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</b>

		<b>mbështetet operatori ekonomik</b>		

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

<b>Deklarata</b>
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarimenëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: _____ _____ etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.  
*Sqarime nëse vlerësohet nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.  
*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.  
*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.  
Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.  
*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.  
*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

#### **B: DEKLARATA “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura”**

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj Se:  
Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.  
Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër<sup>7</sup>.  
Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:  
çmimet;  
metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;  
qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,  
paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.  
